

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Titulli i prokurimit:	Furnizim , mbjellja e lule dhe drujë dekorativ për MDAP
Nr. i prokurimit:	202-26-6021-1-2-1
Nr. i brendshëm i prokurimit:	

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj:	LULISHTJA LABI-A shpk	
Adresa e plotë, vendi dhe kodi postar:	Rruga – B, Prishtinë	
Numri Telefonit:	049 777 408	
Numri i Faks-it:	nn	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:	Selviye Buçaj	
Adresa elektronike:	lulishtjalabi_a@yahoo.com	
Data e parashtrimit të kërkesës:	04.09.2026	
Nënshkrimi dhe vula:		

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË. **NA**

Emri i përfaqësuesit:	
Adresa e plotë:	
Numri i Telefonit:	
Numri i faks-it:	
Adresa elektronike:	
Data e parashtrimit të kërkesës:	
Nënshkrimi dhe vula:	

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

22.07.2026 - B05 – Njoftimi për kontratë;
22.07.2026 -Dosja e Tenderit;
03.08.2026 – Dorëzimi i Ofertave;
03.08.2026 – Raporti i hapjes;
19.08.2026 – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues;
22.08.2026 – Kërkesa për rishqyrtim të vendimit;
27.08.2026 – Vendimi i AK – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim;

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

22.08.2026 – Kërkesa për rishqyrtim të vendimit;
27.08.2026 – Vendimi i AK – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim;

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK, me rastin e publikimit të dokumentit Njoftimi mbi Vendimin e AK dt. 19.08.2026 dhe shpalljen e fituesit, ka vepruar në kundërshtim me LPP-së neni, 1, 7, 59, 61 dhe 72 dhe Rregulloren për Prokurim Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika (c), 38 paragrafi 38.5, neni 41 paragrafi 41.1 dhe 41.4.

***Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

AK, me dt. 19.08.2026 ka lëshuar dokumentin **“B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK dhe Letrat Standarde”**.

Përmes dokumentit “Letra standarde për Tenderuesin e pasuksesshëm” AK na ka njoftuar se oferta jone ishte e pa suksesshme për arsye të çmimit, dhe përmes dokumentit “B58 – NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUESD” AK ka njoftuar se e ka grupin e OE N.T.P. LULISHTJA BUÇAJ; D.P.T. Lulishtja Labi, GUSHTERICE E ULET, 10500, GRACANICE, e ka shpallur fitues të tenderit.

Me dt. 202.08.2026 kemi pasur qasje në dosje në OE fitues, dhe nga analizimi i ofertës së këtij OE ne kemi gjetur se disa dokumente që nuk përputhen me kërkesat e DT-se, si;

- ❖ Në DT pjesa e FDT-se - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Certifikata pika e 4 është kerkuar: 4. Një (1) florist-e të diplomuar ose certifikuar, ndërsa si dëshmi janë kerkuar “ Diploma ose Certifikata përkatëse – (kopje). Kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje)”.

Lidhur me këtë kërkesë OE i shpallur fitues ka dorëzuar dokumente për znj. Natyra Bytyqi, si;

- Kontratën e Punës për znj. Natyra Bytyqi;
- Certifikatën për Fluriste – Certificate of Completion për “Professional Floristry Training” me nr. CRTCH-XK-PFT-23.06.2026 dt. 23.06.2026;

Gjate analizimit të faqes së kompanisë CERTECH Global, ne kemi gjetur se kjo kompani është e certifikuar nga NAC (National Accreditation Center) (si dëshmi shiko kopjen e bashkangjitur), mirëpo me dokumentet e kësaj certifikate nuk potencohet në asnjë pikë të akreditimeve se kompania CERTECH Global, është e akredituar për mbajtjen e trajnimeve për Floristë. (<https://www.certechglobal.com/indexen.asp>).

Përveq kësaj kjo certifikatë dëshmon se kompania Certech Global është e certifikuar me standardin ISO/IEC 17021-1:2015 e cila mbulon fushat e akreditimit si:

- ISO-9001:2015 - **Quality Management Systems,**
- ISO-14001:2015 - **Environmental Management Systems,**
- ISO-45001:2015 - **Occupational Health and Safety Management Systems,**
- ISO-13845:2016 - **Medical Device Quality Management Systems,**
- ISO-27001:2017 - **Information Security Management Systems,**
- ISO-22000:2018 - **Food Safety Management Systems,**
- ISO-50001:2018 - **Energy Management Systems;**
- ISO-37001:2025 - **Anti-Bribery Management Systems;**
- ISO-37301:2021 - **Compliance management systems Requirements with guidance for use;**

certifikime keto që nuk mbulojnë fushën e trajnimeve dhe certifikimeve për fluriste.

Sepse certifikimi ISO-17021-2015 mbulon fushat e lart cekura për organet që ofrojnë auditim dhe certifikim të sistemeve të menaxhimit, siç detajohet në shtojcë (referoju certifikatës nga NAC të bashkangjitur).

Prandaj duke analizuar keto dëshmie (në webfaqen e CERTECH Global) ne konsiderojmë se kompania CERTECH Global nuk ka akreditime të licencuara për të lëshuar certifikime për fluriste, prandaj si e tillë kjo certifikatë është e pavlefshme.

Po ashtu në DT të FDT nën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 pika 5 kërkohej - Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të disponojë me një hapësirë (lokal) në Komunën e Prishtinës, në pronësi ose me qira shfrytëzimi, për ofrimin e shërbimeve. Hapësira duhet të jetë e vendosur në një distancë prej së paku 3 (tre) km dhe jo më shumë se 4 (katër) km nga objekti i Kullës së Rilindjes – MDAP. Lokacioni duhet të dëshmohet përmes Google Maps ose një mjeti tjetër të besueshëm të hartografimit, ndërsa Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për ta verifikuar atë”, kërkesë kjo e cila ka për qëllim mbulimin dhe realizimin e shpejta të porositë për AK.

Në kuadër të kësaj kërkesë nënkupton që edhe lokali si e tillë duhet të posedojë në orarin e punës edhe fluristen, në këtë rast znj. Natyra Bytyqi.

Duke analizuar dokumente të OE të shpallur fitues ne kemi gjetur që dëshmia e lokalit të ofruar për këtë pikë nga OE është në pronësi të anëtarit të konzorciumit D.P.T. Lulishtja Labi (shiko dokumentin e ofertës së OE “10.Lokali, Pronesia:”), ndërsa znj. Natyra Bytyqi figuron si punonjëse e anëtarit tjetër të konzorciumit OE N.T.P. LULISHTJA BUÇAJ (si dëshmi shiko dokumentin “7. Lista e stafit dhe kontratat Lulishtja Buçaj”).

Po ashtu ne nuk kemi gjetur asnjë deklaratë apo dëshmi me të cilën anëtarët e konzorciumit janë dakorduar se znj. Natyra Bytyqi si fluriste (edhe pse e pa certifikuar) do të punojë në dyqanin e deklaruar si pikë shtije dhe kujdesi për AK.

AK MDAP në vendimin e dt. 27.08.2026 lidhur me kërkesën tone për rishqyrtim të dt. 22.08.2026, lidhur me verifikimin e kësaj pike, që për ne ishte kontestuese, ka dhënë këtë përgjigje;

“Në këtë drejtim, OE i rekomanduar për kontratë, për personin e propozuar znj. Natyra Bytyqi, ka dorëzuar dokumentin "Certificate of Completion - Professional Floristry Training", me nr. CRTCH-XK-PFT-23.06.2026, të datës 23.06.2026, i cili dëshmon përfundimin e trajnimit profesional dhe, rrjedhimisht, përmbush kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe njoftim për kontratë të vendosura nga AK. Dokumenti i paraqitur është i identifikueshëm dhe i verifikueshëm përmes QR Code-it të përfshirë në certifikatë, çka mundëson verifikimin e autenticitetit të dokumentit online shih foton” mbyllet citati (për më shumë dëshmi referoju dokumentit “Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim 27.08.2026”).

Po ashtu AK, ne këtë dokument ka të bashkangjitur edhe një faqe të një emali përmes të cilit verifikon se ka komunikuar me lëshuesin e kësaj certifikate për znj. Bytyqi kompaninë Certech Global (për me shumë dëshmi referoju dokumentit “Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim 27.08.2026”).

Mirëpo, AK nuk ka ofruar asnjë dëshmi se e ka sqaruar me kompaninë Certech Global, certifikimet e saj, të kontestuara nga ne, si dhe kompetencën e saj lidhur me lëshimin e certifikatave për flurist si pas standardeve ISO 17024, të cilat kompetenca ishin kontestuar nga ne në kërkesën tonë për rishqyrtim.

Prandaj për ne si OE ankues, përgjigjja e AK MDAP dëshmon edhe një herë se AK nuk është marrë fare me verifikimin dhe vërtetimin e pretendimeve tona.

Sepse ne si OE ankues asnjë herë nuk e kemi kontestuar origjinalitetin e certifikatës për znj. Bytyqi, e as lëshuesin e saj Certech Global, por ne si pas hulumtimeve dhe të dhënave të publikuar nga vete kompania Certech Global, e kemi konstatuar licencimin dhe certifikimin e saj me standarde adekuate për të mbajtur trajnime dhe për të lëshuar certifikatë për flurist.

Sepse, ashtu si e kemi sqaruar edhe më lart, e edhe në kërkesën tonë për rishqyrtim, dëshmohet se kompania Certech Global është e certifikuar me standardin ISO/IEC 17021-1:2015 nga kompania NAC për kode të caktuar, të cilat kode dhe fusha të trajnimit asnjëra nuk e mbulon fushën e certifikimit apo trajnimit për fluriste.

Sepse standardi **ISO/IEC 17021-1** është një standard ndërkombëtar që përcakton parimet dhe kërkesat për kompetencën, konsistencën dhe paanshmërinë e trupave që ofrojnë auditim dhe certifikim të të gjitha llojeve të sistemeve të menaxhimit. I publikuar në versionin e tij aktual si **ISO/IEC 17021-1:2015**, ky standard shërben si "rregullorja" bazë për vetë organizmat certifikues (si ata që certifikojnë bizneset me ISO 9001, ISO 14001, ose ISO/IEC 27001). Ai garanton që këto trupa të palës së tretë veprojnë në mënyrë të besueshme dhe të pranueshme ndërkombëtarisht.

Ndërsa standardi **ISO/IEC 17024** është standardi ndërkombëtar që përcakton kërkesat për **organizmat që kryejnë certifikimin e personave (profesionistëve)**. Në terma të thjeshtë, ndërsa standardet e tjera (si ISO 9001 ose ISO 14001) certifikojnë kompani ose procese, ISO/IEC 17024 përdoret për të vërtetuar se **një individ specifik ka njohuritë, aftësitë dhe kompetencat** e nevojshme për të kryer një profesion apo detyrë të caktuar.

Pra si mund ta shihni edhe nga sqarimi më lart, por që mund ta verifikoni edhe në webfaqet në internet, shihet se certifikimi që mban kompania Certech Global ISO/IEC 17021-1 nuk mbulon fushën profesionale të kësaj kompanie për të mbajtur trajnime dhe për të lëshuar certifikime për kompetencat e individëve, e në këtë rast as për fluriste.

Prandaj nga këto të dhëna, dhe nga sqarimet tona ne nuk e kemi vlerë në dyshim origjinalitetin e certifikatës të znj. Bytyqi, të lëshuar nga kompania Certech Global, sepse ai dokument mund të verifikohet edhe në webfaqen e kompanisë lëshuese, mirëpo ne kemi kontestuar mungesën e certifikimeve dhe standardeve adekuate për kompaninë Certech Global, sepse të dhënat tregojnë se ajo nuk është e certifikuar me standardin adekuat ISO/IEC 17024, i cili standard i garanton mbajtjen e trajnimeve dhe lëshimin e certifikatave për kompetencat e individëve, e në këtë rast për fluriste.

Prandaj, ne vlerësojmë se AK duke mos e verifikuar dhe analizuar kompetencat e lëshuesit të kësaj certifikate si dhe punonjësit e lokalit të OE të shpallur fitues, dhe duke i pranuar si të mirëqena dokumentet e dorëzuara nga ky OE, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e DT-se, si dhe në kundërshtim me LPP neni, 1, 7, 59, dhe 72 dhe Rregulloren për Prokurim Publik neni 38 paragrafi 38.5.

Një pikë tjetër që ne kemi gjetur që oferta e OE të shpallur fitues nuk përputhet me kërkesat e DT-se si dhe LPP neni 1, janë cmimet e ofruara nga OE i shpallur fitues, i cili për disa pozicione ka ofruar çmime jashtëzakonisht të ulëta dhe për disa pozicione ka ofruar çmime jashtëzakonisht të larta.

Si dëshmi ne po ju bashkëngjisim tabelën e cimeve ku ne kemi bërë një krahasim të çmimeve të OE të shpallur fitues me cmimet e ofertës tone, ku ju do të verifikoni se OE i shpallur fitues ka manipuluar jashtëzakonisht shumë me çmime.

JU do të verifikoni, se OE për disa pozicione ka vendosur deri 1700% çmime me të ulëta se ato të tregut, kurse për disa produkte (për të cilat si duket ka pasur ndonjë informacion, apo për të cilat ka parashikuar se do të shpenzohen me shumë nga AK), ka vendosur çmime shumë të larta duke tejkaluar cmimet e tregut mbi 100%.

Ndërsa AK, as me rastin e vlerësimit të ofertave, e as në përgjigjen e tij me dt. 28.08.2026, nuk është lëshuar fare në analizimin dhe verifikimin e çmimeve të ofertës së OE të shpallur fitues.

Prandaj, ne vlerësojmë se AK duke mos e verifikuar dhe analizuar çmimet e ofertës së OE të shpallur fitues dhe duke i pranuar si të mirëqena, AK ka vepruar në kundërshtim me karkaste DT-se, si dhe në kundërshtim me LPP neni, 1, 7, 59, 61 dhe 72 dhe Rregulloren për Prokurim Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika (c), 38 paragrafi 38.5 dhe neni 41 paragrafi 41.1 dhe 41.4..

Prandaj, bazuar në të gjitha këto shkelje dhe devijimet të faktuara me lartë, që AK me ose pa qellim i ka lëshuar gjatë udhëheqjes, vlerësimit të këtij tenderi në kërkojmë nga Organi i Shqyrtimit për Prokurim Publik (OSHP) si organ kompetente dhe i autorizuar nga ligj që të nxjerr;

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE Lulishtja LABI-A shpk,;

ANULOHET, vendimi i AK-së i datës 19.08.2026 dhe lënda të kthehet në RIVENDOSJE dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik, Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik dhe Udhëzimit nr. 01/2023 për Prokurim Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlerësimi i gabuar nga AK na shkakton dëme materiale dhe në reputacion.

Vërejtje: Të gjitha dokumentet e cekura në këtë Kërkesë për rishqyrtim, një kopje të tyre e posedon edhe AK-e në formë elektronike ose fizike.